

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Kolegji i përbërë nga gjyqtarët Gani Zabeli, Kryetar, Rasim Rasimi dhe Biljana Rexhiq, anëtarë me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve Z.R. dhe H.S. nga K. Vitisë, për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit në bashkëveprim nga neni 385 par 2 lidhur me par 1 dhe nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, dhe përgjigjes në ankesë të akuzuarve të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Viti, P.nr.185/2014, të datës 30.09.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 17.01.2017, mori këtë:

AKTGJYKIM

Me rastin e ankesës të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, e sipas detyrës zyrtare ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti P.nr.186/14 i datës 30.09.2016, përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale, ashtu që gjykata e Apelit gjen se në veprimet e të akuzuarve Z.R. dhe H.S., formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhje e pyllit në bashkëveprim nga neni 285 par 2 lidhur me par 1 dhe nenin 20 të KPK-së , kurse dënimi i shqiptuar për veprën për të cilën janë shpallur fajtor iu merret si i vërtetuar.

Arsyetim

Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Viti, me aktgjykimin, P.nr.185/2014, i datës 30.09.2016, të akuzuarit Z.R. dhe H.S. i ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit në bashkëveprim nga neni 385 par 2 lidhur me par 1 dhe nenin 31 të KPRK-së, dhe për këto vepra i ka shqiptuar dënim burgu në kohëzgjatje prej nga 90(nëntëdhjetë) ditësh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, me kusht që në afat prej 1(një) viti mos të kryejnë vepra tjera penale në të kundërtën dënimi i tillë do të revokohet.

I ka obliguar te akuzuarit që në emër ta paushallit gjyqësor te paguajnë shumen prej nga 20 euro. E dëmtuara APK në Viti , për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar ne kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe e ligjshme ndërsa aktgjykimin e ankimuar të ndryshohet ashtu që të akuzuarve t'iu shqiptohet një dënim më i lartë

Përgjigje në ankesën e Prokurorit kanë paraqitur të akuzuarit Z.R. dhe H.S., me propozim që ankesa e Prokurorit të refuzohet si e pabazuar kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokurori i Apelit me parashtresën PPA/Inr.1403/2016, të datës 14.11.2016, ka propozuar që të aprovohet ankesa Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që të akuzuarve t'iu shqiptohet një dënim më i lartë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet në ankesë gjeti se :

Ankesa është e pabazuar.

Aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi dhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së, dhe gjeti se aktgjykimi i shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij.

Siç del nga shkresat e lëndës të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë, që është mbështetur në faktet që përmbanë aktakuzën, në provat e prezantuara nga Prokuroria, të cilat kanë qenë të pranuar nga të akuzuarit. Gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase siç rezulton nga shkresat e lëndës të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë për veprën penale, prandaj, sipas nenit 383 par 2 të KPP, ndaj aktgjykimin që është marr në bazë të pranimit të fajësisë, ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve.

Duke e shqyrtuar aktgjykimin përkitazi me shkeljen e ligjit penal, sipas detyrës zyrtare, sipas vlerësimit të kësaj gjykate në këtë rast është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit, me cilësimin e gabuar të veprës penale, shkelje kjo nga neni 385 par 1 nën par 1.4 .KPP-së.

Sipas dispozitës së nenit 3 të KPP-së, ndaj kryesit zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, por në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm.

Nga shkresat e lëndës rezulton se vepra penale është kryer me datën 19.08.2011, pra në kohën kur është zbatuar Kodi penal i Kosovës sipas së cilit për veprën penale vjedhje pylli ka qenë i paraparë dënimi me gjobë ose me burgim prej 6 muajve deri në 5 vjet. Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur më vonë, kur ka qenë në zbatim KPRK-së i cili ka hy në fuqi me datën 01.10.2013, me këtë kod për veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par 2 të KPRK-së është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim prej 3 muajve deri në 3

vjet. Andaj përderisa me Kodin Penal të Kosovës i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale për këtë vepër penale kanë qenë të parapara dy dënime por në mënyrë alternative-dënimi me gjobë ose dënimi me burgim, me kodin penal të Kosovës i cili zbatohet në kohën e gjyqimit këto dy dënime janë të parapara në mënyrë kumulative.

Sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës së Apelit për të akuzuarin është më i favorshëm ligji i cili parasheh mundësinë që të akuzuarit ti shqiptohet ose dënimi me gjobë ose dënimi me burgim e jo ligji i cili e obligon gjykatën që ti shqiptoj të dy llojet e dënimeve dhe në këtë pikëpamje kërkesa ishte e bazuar. Nga kjo u vendos që aktgjykimi i shkallës së parë të ndryshohet si në dispozitiv, pra që vepra penale juridikisht të cilësohet si vepër penale vjedhje pylli nga neni 285 par 2 të KPK-së dhe për këtë vepër penale të akuzuarit ti hiqet dënimi me gjobë, kurse dënimin me burgim t'ia merr si të vërtetuar, me bindje se edhe një dënim i tillë është në përpjesëtim me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimin të parapare me dispozitën e nenit 41 të KPK-së.

Nga kjo që u tha më lartë, e në bazë të nenit 403 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1nr. 1370/16, me dt. 17.01.2017

Procesmbajtësi
Bujar Balaj

Anëtarët e kolegjit

1. Rasim Rasimi

2. Biljana Rexhiq

Kryetari i kolegjit
Gani Zabeli